

# MARCONOL SUPERMARE

LLAK TRANSPARENT POLIURETAN MONOKOMPONENT ME SHKËLQIM OSE SATIN PËR JASHTË  
SERI 848

## PËRSHKRIMI

MARCONOL SUPERMARE është llak transparent, me solvent, për dru, që lejon përfitim e një finiture me shkëlqim ose satine. Lidhësi, me bazë rezinë alkidike uretane, mundëson përdorimin e produktit edhe për jashtë në kushte të ekspozimit të lartë ndaj agjentëve atmosferikë dhe në ambiente detare. Produkti ofron plotësi të shkëlqyer, është i lehtë për t'u aplikuar dhe ofron shtrirje të mirë. MARCONOL SUPERMARE është i disponueshëm në versionin lucido (me shkëlqim) ose satin. Është i mundur përfitimi i shkëlqimit mesatar (gjysmë-shkëlqim) duke përzier midis tyre MARCONOL SUPERMARE Lucido (me shkëlqim) me MARCONOL SUPERMARE satin.

## UDHËZIME PËR PËRDORIMIN

I aplikueshëm në dru të ri ose të lyer, brenda dhe jashtë, papafingo, korniza dritarësh, ballkone, gardhe etj.

## KARAKTERISTIKA TEKNIKE

- Natyra e lidhësit: rezinë alkidike me modifikime uretane
- Solventi: përzierje e hidrokarbureve alifatikë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1:  $0,90 \pm 0,05$  kg/l
- Viskoziteti i paketimit UNI 8902 në 25 °C:  
.8480819 Lucido (me shkëlqim):  $270 \pm 30$  cps  
.8480638 Satin:  $400 \pm 80$  cps
- Shkëlqimi UNI EN ISO 2813:  
.8480819 Lucido (me shkëlqim):  $>90$ , këndi i leximit  $60^\circ$   
.8480638 Satin:  $45 \pm 5$ , këndi i leximit  $60^\circ$
- Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): larg pluhurave për 2 orë; prekja pas 6 orësh; shtresa tjetër pas 12 orësh.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

- Sipërfaqe të reja, solid ose kompensata:
- Zmeriloni lehtësisht për të hequr/larguar fibrat e ngritura të drurit.
- Hiqni rezinën/llakun e pranishëm duke përdorur diluentin e përshtatshëm.
- Stukoni parregullsitë me stuko sintetike. Zmeriloni stukimet dhe eliminoni pluhurin.
- Kontrolloni që druri të mos jetë shumë i lagësht.
- Në dru të butë (legni teneri) ose të tharë ose shumë absorbues, aplikoni një shtresë MARCONOL IMPREGNANTE të ngjyrosur/pigmentosur seri 843.

-Në dru të ekspozuar jashtë këshillohet gjithmonë trajtimi në 2 shtresa me MARCONOL IMPREGNANTE të ngjyrosur/pigmentosur seri 843.

-Zmeriloni sipërfaqet dhe vazhdoni me aplikimin e 2 shtresave MARCONOL SUPERMARE, me interval prej 12 orësh, duke ndjekur udhëzimet e përkrahura në udhëzime për aplikim.

Sipërfaqe në dru të lyer

-Zmeriloni lehtësisht për të hequr/larguar fibrat e ngritura të drurit.

-Eliminoni shtresat e bojës së vjetër të ciflosur dhe ashpëroni/zmeriloni të gjithë sipërfaqen e lyer.

-Hiqni rezinën/llakun e pranishëm duke përdorur diluentin e përshtatshëm.

-Stukoni parregullsitë me stuko sintetike.

Zmeriloni stukimet dhe eliminoni pluhurin.

-Në zonat e degraduara ose shumë absorbuese, aplikoni një shtresë të MARCONOL IMPREGNANTE të pigmentosur seri 843.

-Në dru të ekspozuar jashtë është gjithmonë i këshillueshëm trajtimi paraprak me 2 shtresa të MARCONOL IMPREGNANTE të pigmentosur seri 843.

-Zmeriloni sipërfaqet dhe vazhdoni me aplikimin e 2 shtresave MARCONOL SUPERMARE, me interval prej 12 orësh, duke ndjekur udhëzimet e përkrahura në udhëzime për aplikim.

## UDHËZIME PËR APLIKIM

-Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:

Temperatura e ambientit: Min.  $+8$  °C / Max.  $+35$  °C

Lagështira relative e ambientit:  $<75\%$

Temperatura e sipërfaqes: Min.  $+5$  °C / Max.  $+35$  °C

Lagështira e sipërfaqes:  $<10\%$

-Shmangni aplikimet në prani të sipërfaqeve me kondensim ose nën veprimin direkt të diellit

-Mjetet: pinel, rrul.

-Ripërzieni në mënyrën e duhur produktin para përdorimit.

-Hollimi: gati për përdorim.

-Aplikimi me spruco mund të kryhet ekskluzivisht në kontekstin e aktiviteteve që janë subjekt i autorizimeve për emisionin (lëshimin) në atmosferë (art. 267 dhe ndjekur nga D.L nr. 152/2006), hollimi paraprak 10% me Acquaragia 5200010.

-Nr shtresave: 2 shtresa.

-Pastrimi i mjeteve bëhet me Acquaragia 5200010.

# MARCONOL SUPERMARE

LLAK TRANSPARENT POLIURETAN MONOKOMPONENT ME SHKËLQIM OSE SATIN PËR JASHTË  
SERI 848

-Shkalla e mbulimit: 8-9 m<sup>2</sup>/l në 2 shtresa në dru mesatarisht absorbues. Është mirë që të përcaktohet rrezja efektive me një provë paraprake në sipërfaqe specifike konsumi.

## NGJYROSJA

Produkti është i disponueshëm në versionin lucida (me shkëlqim) kod. 8480819 dhe satin kod. 8480638.

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C  
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C  
Produkti preferohet të përdoret brenda 3 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)  
Kat. A/e: Ilaqe dhe mbushësa (impregnanti) për dru për finitura të brendshme/jashtme (bazë solventi): 500 g/l (2007) / 400 g/l (2010)  
MARCONOL SUPERMARE Përmban max: 400 g/l VOC

I dëmshëm- I ndezshëm  
Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe ruhet sipas rregullave aktuale të shëndetit dhe sigurisë; pas përdorimit mos i hidhni mbetjet në ambient, i lini të thahen dhe i trajtoni ato si mbetje të veçanta.  
Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

## SPECIFIKIMET

Llak transparent poliuretan monokomponent për brenda dhe jashtë.  
Aplikimi, në sipërfaqe druri të predispozuara, për llak transparent poliuretan monokomponent për brenda dhe jashtë MARCONOL SUPERMARE kod. 8480819/638, me bazë rezinë alkidike të uretanizuar në të paktën 2 shtresa, në sasinë e caktuar nga absorbimi i sipërfaqes.  
Furnizimi dhe instalimi i materialit € ..... për m<sup>2</sup>.

*SAN MARCO GROUP* garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti i produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.